



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
DREJTORIA E FINANCËS DHE BUXHETIT

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 11.11.2025, në ora 16.30, në Dëgjuesën Publike të zhvilluar me qytetarët dhe grupet e interesit, lidhur me Projektbuxhetin Afatmesëm 2026-2028, Buxhetin Vjetor 2026 dhe Paketën Fiskale për vitin 2026, Faza Përfundimatare.

Dëgjesa Publike bëhet me banorët dhe grupet e interesit të Njësive Administrative SHËNKOLL, ZEJMEN DHE KOLSH.

Numri i pjesëmarrësve gjithsej është 111 veta, nga këto: 26 vajza/gra.

Pjesëmarrës nga Bashkia :

1. Pjerin Ndreu me detyrë Kryetar i Bashkisë
 2. Brikena Vuksani me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë
 3. Eueda Molla me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë
 4. Fatjon Zefi me detyrë Zv/Kryetar i Bashkisë
 5. Ndue Luli me detyrë Kryetar i Këshillit të Bashkisë
 6. Zhaneta Frroku me detyrë Administrator i Njesisë Shënkoll
 7. Xhoana Kodra me detyrë Administrator i Njesisë Kolsh
 8. Leonard Përlaku me detyrë Administrator i Njesisë Zejmen
- si dhe anëtarët e tjerë të Grupit Menaxhimit Strategjik.

Takimi u drejtua nga Kryetari i Bashkisë z.Pjerin Ndreu, ku :

♦ Shpjegoi qëllimin e kësaj dëgjese publike.

♦ Prezantoi Projektprogramin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028, Buxhetin dhe Paketën Fiskale për vitin 2026, e në veçanti projektet e investimeve që do të zbatohen, shërbimet që do të kryhen dhe nivelin e taksave dhe tarifave që do të aplikohen.

Pjesëmarrësit që morën fjalën dhe diskutuan, dhanë këto mendime dhe propozime:

Z.Mëhill Ndreca, fshati Rilë dha këtë mendim dhe propozim:

1-Çfarë do bëni për përmirësimin e sinjalistikës nga Barbulloja në Rilë-Tale .

Përgjigje:Faktikisht në këtë aks ka probleme, por ne do të ndërhyjmë për përmirësimin e saj.

Z.Gjac Gjaci, fshati Rilë, dha këtë mendim apo propozim:

1-Kërkojmë të sistemohet rruga Lleshaj, në fshatin Rilë.

Përgjigje: Ky aks rrugor është planifikuar të sistemohet dhe asfaltohet.

Z.Mark Doda, fshati Grykë Lumi dha këtë mendim apo propozim:

1-Të përmirësoni punën lidhur me cilësinë e zbatimit të investimeve.

Përgjigje: Ne kemi një strukturë që merret me menaxhimin e zbatimit dhe cilësisë së investimeve.

Z.Mark Gega, fshati Lalm i Ri, dha këtë mendim apo propozim:

1-Kemi problem për një ambulancë në lagje .

Përgjigje: Ky problem është në zgjidhje me Drejtorinë e Shëndetit Publik Lezhë.

Z.Zef Gjeçi, fshati Gryjë Lumi, dha këtë mendim apo propozim:

1-Kemi probleme me transportin publik në fshatrat Shënkoll, Tale, Hidrovor, Rrilë, etj.

Përgjigje: Do bëjmë planin e transportit dhe do e japim me sipërmarrje këtë shërbim.

Mbajtësi i procesverbalit

Xhemal Haxhia



Sekretari i GMS-së
Mariolina Lleshi



Kordinatori i GMS-së
Brikena Vuksani









